



Datë: 08.07.2025
Numër Protokolli: 4636/2025

A.nr.782/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani dhe, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.782/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesi M.K kundër organit të punësimit: Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër me numër A.nr.782/2025, e datë 30.04.2025, e parashtruar nga ankuesi M.K.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil M.K (*tutje referuar ankuesi*), më datë 30.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 08.04.2025 për rezultatin përfundimtar, lidhur me konkursit me Nr. Reference RN00016470 të datës 27.0.2025 për Drejtues të Larë pozita Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (*tutje MFPT*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.782/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se MFPT, më datë 27.01.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference RN00016470 për Drejtues të Larë pozita Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me afat të aplikimit nga data 28.01.2025 deri më datë 26.02.2025.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton së në këtë konkurs kanë aplikuar ankuesi i cili është përfshirë në listën e verifikimit paraprak dhe në fazat tjera të procedurës.

Pas përfundimit të procedurës, Njësia e Burimeve Njerëzore e MFPT-së, më datë 08.04.2025 ka shpallur njoftimin për rezultatet përfundimtare, e në bazë të të cilit kanë rezultat katër kandidatë fitues mesin e tyre edhe ankuesit i renditur me pikë i dyti.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidatja Nj.M-B, si kandidatë aplikuese në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference RN00016470, më datë 27.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.789/2025, ka anuluar në tërsi procedurën e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me Numër Reference: RN00016470, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës së ankuesit A.nr.782/2025, të datës 30.04.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.789/2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërsi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me Numër Reference: RN00016470, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.782/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.782/2025, të datës 30.04.2025.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.782/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit M.K;*
- *Udhëheqëses të Divizionit të Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;*
- *Udhëheqëses të Divizionit të Burimeve Njerëzore, të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*